
RECENSIONE

DRITAN EGRO: “HISTORIA DHE IDEOLOGJIA: NJË QASJE KRITIKE STUDIMEVE OSMANE NË HISTORIOGRAFINË MODERNE SHQIPTARE (NGA GJYSMA E DYTË E SHEK. XIX DERI MË SOT)”, **Shtëpia Botuese “Maluka”, Tiranë, 2007, 244 f.**

Brezi i ri i historianëve po ofron gjithnjë e më shumë lajme të mira për një historishkrim të dëshirueshëm. Edhe optimistët më të dalluar nuk do të prisnin një ndryshim kaq cilësor dhe të shpejtë që pritej se do të ndodhte.

Më 12 dhjetor të vitit 2007 në Prishtinë, Instituti i Historisë- Tiranë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Prishtinë, promovoi dymbëdhjetë veprat më të reja të tij. Njëra ndër to është edhe vepra e Dritan Egro-s, *Historia dhe Ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare*, e cila është një nga veprat e rralla të këtij lloji. Kjo vihet re nga vetë titulli i saj. Mirëpo, kjo përshtypje do të thellohet edhe më shumë pas leximit të vëmendshëm të saj.

Shembull për të mirë

Që në fillim të leximit shihet se vepra e parë e Dritan Egro-s është shembull i mirë se si teoretizohet apo se si ngrihet në shkallë teorie një çështje historike të thuash gati e panjohur, siç është historia dhe historiografia e sundimit osman në viset shqiptare. Që ta bëjë këtë, autorit i është dashur një përgatitje solide, por krahas kësaj edhe një punë shumëvjeçare duke grumbulluar e pastaj shqyrtuar e trajtuar një varg veprash në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj.

Ndonëse autori pohon se në këtë vepër nuk janë përfshirë të gjitha veprat dhe arritjet e historiografisë, por vetëm ato që janë më të njohura, nga një vështrim i kujdesshëm i bibliografisë (faqe 215 – 237) shihet se autori me këtë rast ka përdorur më se 380 vepra mbi 240 autorë që janë marrë me periudhën osmane në viset shqiptare, në Ballkan, Evropë e më gjerë, si dhe një varg veprash teorike dhe metodologjike. Për këtë arsye kjo bibliografi në fund të kësaj vepre jo vetëm që ka karakterin

informativ, por është e mirëseardhur edhe për shfrytëzim nga të interesuarit.

Shfrytëzimin e lehtë të kësaj vepre do ta ndihmojë mjaft edhe regjistri i emrave të njerëzve, mirëpo shumë më me interes janë të dhënat informative dhe kritike, si dhe qëndrimet dhe vështrimet e ndryshme dhe të shumta të kësaj vepre. Me këtë rast duhet përmendur edhe neologjizmi i autorit *historishkrim*, i cili jo vetëm që zëvendëson termin *historiografi*, por shpreh edhe veprimin e regjistrimit të asaj se çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

Konkurrenca me botën

Autori i kësaj vepre pa hezituuar shpreh qëndrimet dhe shqetësimet e veta të sinqerta dhe në këtë mënyrë plotëson njërin nga kriteret më qenësore të shkrimeve bashkëkohore (f. 4-5). Kuptohet kjo veçori në këtë vepër u arrit edhe për faktin se autori veprat shkencore objektivist i konsideron si burime historike dhe si pasojë ai mendon se ato duhet të studiohen e vrojtohen me metoda dhe forma të studimit të dokumenteve origjinale (f. 27). Por, Dritan Egro është plotësisht i bindur se “historiani, ashtu si edhe studiuesi i shkencave sociale në përgjithësi, është produkt i një momenti të caktuar historik, ndaj në veprën e tij ai reflekton mentalitetin dhe dinamikën e një epoke të caktuar; pra pasqyron një filozofi të caktuar në kohë” (f. 27). Mbështetur në këtë të dhënë dhe duke marrë si shembull analizat për historiografinë bashkëkohore shqiptare për periudhën e sundimit osman, Dritan Egro me këtë vepër synon të ndriçojë të dhënë se sa ka evoluar historiografia shqiptare në përgjithësi dhe e studimeve osmane në veçanti (27-28). Nënkuptohe vetvetiu, edhe pse gama e përfshirjes së problemeve prek ecurinë e historishkrimit të deritashëm shqiptar, veçanërisht autori ndalet në problemet që lidhen me kohën e sundimit osman, madje i kushton edhe pjesën më të madhe në këtë vepër, dhe kjo është, veç të tjerash, edhe synimi i kësaj vepre. Që të arrihet ky synim, autori këtë kritikë do ta bëjë edhe të ndarë, edhe të integruar (f. 30), në varësi të çështjeve që trajtohen dhe nga qasjet për të cilat është përcaktuar autori, apo do të përcaktohen në të ardhmen nga ata që do të merren me studime të tilla. Po kështu duhet përmendur se Dritan Egro për një studim të tillë gjithëpërfshirës shqyrtoi (disa edhe i ndriçoi) edhe një varg kontributesh të huaja në fushën e historiografisë në përgjithësi dhe osmanistikës në veçanti. Falë kësaj qasjeje në këtë vepër do të gjenden emrat e të huajve dhe shqiptarëve që janë pionierë të hapjes

së hullive të çështjeve të ndryshme historike, por autori do të merret edhe me periodizimin e historishkrimit të osmanistikës dhe me përcaktimin e datave kur për herë të parë u ndërmor ndonjë veprim i natyrës së historishkrimit (f. 3-32).

Qendra e studimeve historike shqiptare

Trajtimi i historiografisë shqiptare bashkëkohore nga Dritan Egro nuk shquhet vetëm me përcaktimet kohore, por edhe me ato të hapësirës. Zhvillimi dhe përhapja e studimeve historike dhe të historiografisë, veçanërisht osmanistikës, nuk është përqendruar vetëm në kufijtë e shtetit të Shqipërisë, por edhe në Kosovë e viset e tjera shqiptare, si edhe në diasporë. Sa shihet nga të dhënat që ofron vetë vepra të cilat dëshmojnë njohjen e mirë të autorit, ai i jep rëndësi këtyre hulumtimeve në Kosovë, diasporë dhe në vise të tjera shqiptare; megjithatë, autori konsideron se Tirana sidoqoftë mbetet qendra e studimeve historike shqiptare (f. 32). Kështu ndodh, veç të tjerash, sepse, sipas autorit “Kosova nuk gëzonte lirinë e duhur”, ndërsa për viset e tjera shqiptare as që mund të flitet. Siç është e kuptueshme, edhe në diasporë historishkrimi shqiptar zhvillohej e karakterizohej varësisht nga vendi ku zhvillohej ajo, por edhe nga ndikimet të cilave historishkruesit u nënshtroheshin (f. 35).

Pasi zhvillimi dhe përhapja e studimit të së kaluarës dhe e historiografisë si shkencë është histori më vete, ajo shoqërohet edhe nga të dhëna të shumta që gjenden në veprën e Dritan Egro-s. Pra, kjo vepër jo vetëm që është ogurmirë për një qasje të re të kritikës dhe të teorisë historike, por është shumë e pasur edhe me të dhëna të reja të panjohura, veçanërisht në fushën e historiografisë që lidhet me historinë e shqiptarëve. Për këtë arsye kjo vepër e Dritan Egro-s, duhet lexuar dhe përdorur edhe për shkak të të dhënave informative të kësaj fushe të studimeve shoqërore.

Vrojtime dhe vlerësime të qëndrueshme

Sadoqë të dhënat e shumta informative të Dritan Egro-s në veprën *Historia dhe Ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane ...*, janë me interes dhe nuk gjenden të grumbulluara në një vend, ato nuk janë veçori e vetme e kësaj vepre. Shumë nga vrotimet dhe vlerësimet e bëra në këtë vepër nga autori bëhen për herë të parë dhe për fat edhe janë të qëndrueshme.

Pasi për herë të parë autori i veprës në shqyrtim bën ndarjen e osmanistikës [1) gjysma e dytë e shekullit XIX – 1945; 2) 1945 – 1990 periudha komuniste dhe 3) 1990 – ditët e sotshme, periudha postkomuniste], si dhe pasi pohon se deri më tani historishkrimi shqiptar në përgjithësi kaloi nëpër periudhën romantike, patriotike, komuniste dhe atë të tranzicionit, autori i kësaj vepre shpreh qëndrime, bën vrojtime e vlerësime të ndryshme për historiografinë shqiptare, që deri më tani janë të rralla dhe të guximshme. Që t’ia arrijë këtyre qëllimeve ky autor së pari do të trajtojë logjikën e ekzistimit dhe rëndësinë e historisë si shkencë. Në këtë frymë, për logjikën e qenësisë së historisë, autori do të citojë Ndoc Nikajn, i cili theksonte që në kohën e tij se “{Njohja e historisë} ban me daa veten prej t’hueive” (f. 46).

Motoja e Ndoc Nikajt është mbështetje qenësore për veçoritë e kësaj vepre dhe të synimeve të autorit të saj. Kjo është arsyeja që në asnjë vepër të deritashme nuk gjenden të thëna kaq shkurt dhe kaq saktë synimet e historianëve dhe të historishkruesve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, por edhe të periudhave të mëvonshme (f. 47).

Edhe pse Dritan Egro në veprën e tij angazhohet maksimalisht për një studim të historisë dhe një historishkrim të përkryer, ai kupton dhe këtë e shpreh haptazi pse shkrimet historike janë përshkruese, në shërbim të kombëtares apo edhe në shërbim të një ideologjie, partie apo organizmi tjetër me ndikim të përkohshëm (f.60). Kështu ndodh, madje, edhe me shkrimet historike në diasporë që vuajnë nga njëanshmëria (shqimi i tepruar i vetvetes), si dhe nga mungesa e shfrytëzimit të dokumenteve historike (f. 34). Thënë ndryshe, edhe pse me vonesë të konsiderueshme historia si shkencë dhe historiografia shqiptare do të kalojë nëpër fazat që kaluan historishkrimet evropiane. Kështu “deri në 1945 shkrimi i historisë perceptohej si një tregim letrar dhe nuk konceptohej si një disiplinë shkencore, e cila do të posedonte një metodologji të saj bashkëkohore” (f. 64). Kjo histori nuk mbështetej në dokumente arkivore dhe në materiale të vjela nëpër biblioteka, por në stilin e rrëfimit dhe ekspozimit të opinionit personal (f. 64). Si e tillë kjo historiografi, e ndikuar nga studiuesit francezë, do të përdoret në një funksion të ndjeshëm pedagogjik (f. 62).

Përpjekjet për përsosje dhe shkalla e saj

Rrjedhat e studimit të së kaluarës dhe të historiografisë në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore do të marrin kahe të tjera. Ato në këtë kohë

do të marrin karakter marksist-leninist, të cilat sipas Dritan Egro-s: “Elita politike komuniste, historinë e konsideroi si politikë të kthyer pas në kohë. Një perceptim i tillë do të vuloste fatin dhe kursin e studimeve historike. Shtetet dhe sidomos ato diktatoriale i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe kontrollit në shkrimin e historisë, madje ato variantin zyrtar të historisë që përkrahin nuk ngurojnë ta ngrenë edhe në nivelin e një rrëfimi hyjnor. Dhe ky rrëfim hyjnor mbetet i tillë për sa kohë që historiografia zyrtare nuk ka alternativë sfiduese. Shfaqja e tezave dhe qasjeve alternative gjithmonë ka ushqyer qëllimin për ta çliruar historiografinë zyrtare nga paradigma politikisht e përcaktuar” (f. 100).

Dobësi e lëshime të historishkrimit shqiptar

Si osmanistikën në veçanti, ashtu edhe historiografinë shqiptare në përgjithësi, e mendojnë, mendon autori, edhe dobësi të tjera pa eliminimin e të cilave vështirë se mund të arrihet te historishkrimi i dëshiruar.

Gjithsesi, sipas Dritan Egro-s, shkenca e historisë dhe historiografia ende ka mbetur në qarqe minore, racionale dhe me këtë edhe divulgative e me funksione të cinguara. Veç kësaj “një historiografi ku vazhdon fuqishëm të mbizotërojë narracioni anakronik, do të vazhdojë të identifikohet më shumë me dimensionin e saj didaktik se sa shkencor” (f. 128).

Të ngarkuar nga nacionalizmi në shkencën e historisë, shumë historianë shqiptarë sot e kësaj dite kanë mbetur në pozicionet e mbrojtjes “së të drejtave historike” (f. 200), si pasojë edhe tek autorët shqiptarë mbizotërojnë temat kombëtare e romantike, ndërsa hetohet ndjeshëm “mungesa e historiografisë shkencore” (f. 201).

Nëse dobësive të lartpërmendura u shtohen të dhënat se studimi i së kaluarës dhe i historiografisë shqiptare vuan nga dukuria e lokalizmit dhe ajo nuk njihet nga shkenca ndërkombëtare, me ç’rast ndikoi shumë edhe mbyllja e Shqipërisë si shtet. Bindja në këtë frymë do të shtohet edhe më shumë nëse shtohet e dhëna se mësimi i historisë nuk bëhet si duhet: nxënësit e studentët nuk mësohen të perceptojnë si duhet, sepse historianëve u mungojnë aftësitë për të analizuar dhe për të interpretuar në mënyrë kritike (f. 203-204).

Synimet dhe dëshirat

Sado që nuk mund të mohohet e dhëna se kritika e mirëfilltë e historishkrimit është synim i kësaj historiografie, autori i veprës *Historia dhe Ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane ...* nuk e thotë gjithherë drejtpërdrejtë, por e lë të nënkuptohet dhe kjo ndodh pothuajse në çdo faqe të kësaj vepre. Në shumë pjesë të veprës, autori nuk do të ngurrojë të shprehë dëshirat për fizionominë e studimeve të së shkuarës dhe të vetë historiografisë. Si fillim do të përmendim devizën e cituar nga vetë Dritan Egro: “të shikosh do të thotë të depërtosh, pasi dihet mirë se ‘është njëmijë herë më lehtë të riprodhosh faktet e një epoke se sa ta rindërtosh atmosferën shpirtërore të saj’. Historiani, pra duhet të ketë një imagjinatë të gjallë për të rikrijuar të kaluarën, pasi fuqia e imagjinatës është esenciale në interpretimin e burimeve historike” (f. 104-105). Që të arrihet kjo, sipas këtij historiani, duhet përkushtim dhe punë e gjatë, kurse “ajo që shkencën historike duhet ta ndajë nga publicistika historike është i menduari filozofik, ...” (f. 122-123).

Arritjet dhe pritjet e studimeve osmanistike

Është e natyrshme që në këtë qasje të shkurtër nuk mund të përfshihet gjithçka është shkruar për çështjen në shqyrtim, por autori do të pohojë se “studimet osmane për Shqipërinë dhe shqiptarët duhet më parë të përfshijnë qasjet në kuadër të Perandorisë Osmane dhe të viseve të tjera të saj, e pastaj edhe të Evropës Perëndimore. Dritan Egro është i sigurt se kjo çështje “e shkëputur dhe e pavarur” nuk mund të trajtohet, siç u veprua deri më tash (f. 131).

Autori i veprës është i mendimit se periudha osmane e historisë shqiptare është e errët dhe për ndriçimin e saj duhet angazhim shumë më i madh se deri më tani. Kjo do të arrihet me dërgimin e të rinjve për t’u aftësuar në botën e jashtme (f. 131).

Si përfundim mund të thuhet se çlirimi nga historiografia “zyrtare” për autorin “është i domosdoshëm, por në Shqipëri mungojnë forcat, sepse ato alternative nuk mund t’i kapërcejnë ato ‘zyrtare’” (204). Historia qëndron mbi politikën dhe mbi qeveritë që ndërrojnë kurdoherë, ndërsa historiani ka religjionin e përjetësisë dhe të së vërtetës – historia shkruhet vetëm duke i besuar së vërtetës dhe duke ndjerë veten të lirë” (205), siç veptoi edhe Dritan Egro, autor i veprës *Historia dhe Ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare (nga gjysma e dytë e shek. XIX deri më sot)*.

Izber HOTI